



# Termet e Referencës për Angazhimin e Ekspertëve

**Titulli i projektit:** Integrimi i sportit në sistemin arsimor të Kosovës

**Klienti:** Federata e Xhudos e Kosovës

## 1. SFONDI:

Federata e Xhudos së Kosovës (FXHK) në kuadër të programit shtetëror “Kosova, shtet i xhudos” është e përkushtuar që të integrojë sportin, veçanërisht xhudos, në kuadër të sistemit arsimor në Kosovë. Për të arritur këtë objektiv, FXHK kërkon të bëjë një analizë gjithëpërfshirëse dhe raport hulumtues mbi kornizën ligjore dhe politikat e tjera qendrore që rregullojnë arsimin dhe sportin në Kosovë. Qëllimi kryesor është identifikimi i qasjes më të mirë për integrimin e sporteve, përfshirë xhudos në shkolla.

## 2. OBJEKTIVAT:

Objektivat kryesore të këtij angazhimi janë:

- **Identifikimi i sfidave në integrimin e plotë të sporteve në sistemin arsimor në Kosovë:** Të shqyrtohen sfidat ekzistuese lidhur me politikat publike, kapaciteteve fizike, financiare dhe njerëzore në integrimin e plotë të aktiviteteve sportive, përfshirë xhudos, si aktivitete kurrikulare apo jashtëkurrikulare në sistemin e arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë.
- **Zhvillimi i një udhëzuesi praktik për palët e ndryshme të interesit për integrimin e plotë të sporteve në sistemin arsimor në Kosovë:** Zhvillimi i një udhëzuesi praktik për veprimet që duhet të ndërmerren në nivel të reformës ligjore (legjislacioni primar dhe sekondar), kornizës programore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, nivelit lokal dhe federatave sportive në ndërtimin e kapaciteteve profesionale në nivel menaxherial dhe operacional për zbatimin e programit “Sporti në Shkolla”.
- **Bashkëpunimi Ndërkombëtar:** Të bashkëpunojë me ekspertë ndërkombëtarë në kuadër të Federatës së Xhudos së Kosovës për udhëzime mbi praktikën më të mira dhe rekomandime ndërkombëtare që kanë të bëjnë me integrimin e sportit në shkolla.

## 3. PALËT E INTERESIT:

- Institucionet qendrore përkatëse;
- Institucionet lokale përkatëse;
- Shkollat;
- Federatat e Sportit - Kosovë.

## **4. FUSHA E PUNËS:**

Fusha e punës përfshinë aktivitetet e mëposhtme:

### **4.1 Hulumtimi, analiza dhe intervistat:**

Shqyrtimi dhe analiza e legjislacionit primar dhe sekondar: T'u bëhet një analizë e thellë të ligjeve dhe rregulloreve aktuale që rregullojnë arsimin dhe sportin në Kosovë. Kjo analizë duhet të sigurojë njohuri mbi kuadrin ligjor që mbështet apo sfidon integrimin e sportit në shkolla.

Intervistat dhe anketat me palët e interesit: Angazhimi në intervista dhe anketa me palët përkatëse të interesit, duke përfshirë institucionet qendrore dhe lokale, autoritetet arsimore, organizatat sportive, mësimdhënësit dhe nxënësit. Këto ndërveprime janë thelbësore për të kuptuar perspektivat dhe shqetësimet e akterëve kryesorë të përfshirë në procesin e integritit të sportit në shkolla.

Shqyrtimi i praktikave më të mira ndërkombëtare: Ekzaminimi i praktikave më të mira ndërkombëtare nga vende e tjera me përvoja të suksesshme në integrimin e sporteve në sistemet e tyre arsimore. Ky shqyrtim do të shërbejë si një burim i vlefshëm frymëzimi dhe referimi.

### **4.2 Rekomandime dhe udhëzime:**

Zhvillimi i rekomandimeve për reformat ligjore (primare dhe sekondare): Bazuar në gjetjet nga analiza ligjore dhe konsultimet me palët e interesit, të hartohen rekomandime të qarta dhe të zbatueshme për reformat ligjore. Këto rekomandime duhet të adresojnë ndryshimet e nevojshme në legjislacionin primar dhe sekondar për të mbështetur integrimin e sportit në shkolla.

Korniza e Programit dhe Inicativat Lokale: Propozimi i një kornizë gjithëpërfshirëse programore për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, e cila përshkruan edhe iniciativat në nivel lokal që mund të përmirësojnë integrimin e sportit në shkolla, duke përfshirë xhudon, në sistemin arsimor. Ky propozim duhet të përfshijë strategji praktike për zbatim.

Krijimi i një plani të veprimit: Krijimi një plani të veprimit për hapat që palët e ndryshme të interesit duhet të ndërmarin për jetësimin e programit në plotni. Ky plani i veprimit duhet të shërbejë si një udhërrëfyes praktik për zbatimin e rekomandimeve, duke siguruar që ato të zbatohen në mënyrë efektive.

### **4.3 Shfrytëzimi i ekspertizës ndërkombëtare:**

Bashkëpunimi me ekspertë ndërkombëtarë: Bashkëpunim i ngushtë me ekspertë ndërkombëtarë përmes Federatës së Xhudos së Kosovës, të shfrytëzohen njohuritë dhe përvojat e tyre në fushën e integritit sportiv në arsim për të informuar dhe pasuruar kërkimet, analizat dhe rekomandimet. Ekspertiza e tyre do të kontribuojë në zhvillimin e një qasjeje të mirëinformuar dhe të harmonizuar globalisht për integrimin e sportit në shkollat e Kosovës.

### **4.4 Analizimi i mundësive dhe sfidave:**

Vlerësimi i mundësive integruese: Analiza e mundësive dhe fizibilitetit të integritit të sportit, përfshirë xhudon, në sistemin arsimor të Kosovës. Ky vlerësim duhet të marrë parasysh infrastrukturën ekzistuese, burimet dhe praktikat arsimore.

Identifikimi i Sfidave dhe Mundësive: Identifikimi i sfidave dhe mundësive të mundshme që lidhen me integrimin e sportit në shkolla. Kjo përfshinë shqyrtimin e faktorëve financiarë, logjistikë dhe kulturorë që mund të ndikojnë në zbatimin e programeve sportive brenda sistemit arsimor.

#### **4.5 Rekomandime për Institucionet Qendrore përkatëse:**

Hartimi i rekomandimeve të qarta dhe të zbatueshme: Bazuar në hulumtimin, analizën dhe kontributin e plotë nga palët e interesit, të hartohen rekomandime të qarta dhe të zbatueshme të përshtatura posaçërisht për Institucionet Qendrore përkatëse. Këto rekomandime duhet të ofrojnë një udhërrëfyes për ndryshimet e politikave dhe zbatimin e programeve për të arritur integrimin e suksesshëm të sportit në shkolla.

#### **5. KUALIFIKIMET E EKSPERTËVE:**

Ekspertët e angazhuar për këtë projekt duhet të kenë këto kualifikime:

- Ekspertizë e demonstruar në politikat arsimore dhe zhvillimin e kurrikulës.
- Njohuri të thella të ligjeve dhe rregulloreve të arsimit dhe sportit të Kosovës.
- Përvojë në kryerjen e hulumtimeve dhe analizave në fushën e arsimit dhe sportit.
- Aftësi të forta analitike dhe shkrimore.
- Njohja me parimet dhe praktikat e xhudos është një plus.
- Një kuptim i thellë i kontekstit lokal të Kosovës, duke përfshirë nuancat kulturore, sociale dhe arsimore.
- Aftësi të forta të menaxhimit, duke përfshirë aftësinë për të koordinuar dhe menaxhuar në mënyrë efektive palët dhe burimet e ndryshme të interesit.

#### **6. PRODUKTET E DORËZUARA:**

Ekspertët pritet të dorëzojnë produktet si vijon:

- Mjetet metodologjike për mbështetjen e të dhënave dhe zhvillimin e analizës së gjendjes ekzistuese.
- Raporti i vlerësimit i politikave publike të arsimit dhe sportit, si dhe identifikimi i sfidave dhe mundësive në integrimin e plotë të sportit në sistemin arsimor në Kosovë.
- Plani i integruar i veprimit për palët e ndryshme të interesit për integrimin e plotë të sportit në sistemin arsimor në Kosovë.
- Metodologjia e punës.

#### **7. AFATI KOHOR:**

Angazhimi pritet të përfundojë brenda periudhës kohore dy mujore.

#### **8. BUXHETI:**

Oferta buxhetore për këtë angazhim duke përfshirë të gjitha shpenzimet duhet të dorëzohet nga aplikues/it/et.

## 9. DORËZIMI I PROPOZIMEVE:

Ekspertët e interesuar ose kompanitë konsulente ftohen të dorëzojnë aplikimet e tyre në **judoksmanagement@gmail.com** deri në **15.10.2023**, me dokumentet mbështetëse, si vijon:

**Letër motivuese:** Një letër e shkurtër motivuese që shpreh interesin për projektin dhe nënvizon përvojën tuaj përkatëse.

**Curriculum Vitae (CV):** Një CV e detajuar që përshkruan arsimin, përvojën profesionale, publikimet (nëse ka) dhe çdo informacion tjetër përkatës.

**Kualifikimet arsimore:** Kopje të diplomave universitare ose certifikatat përkatëse që demonstrojnë kualifikimet në politikën arsimore, menaxhimin e sportit ose fusha të ngjashme.

**Përvoja dhe Referencat:** Një listë e projekteve të mëparshme në lidhje me politikën arsimore, integrimin sportiv ose zhvillimin e kurrikulës. Përfshini informacionin e kontaktit për referenca nëse ka.

**Metodologjia:** Një metodologji e detajuar që përshkruan qasjen tuaj për kryerjen e hulumtimit dhe analizës, duke përfshirë metodat që do të përdorni për intervista, anketa dhe analiza të të dhënave.

**Plani i punës:** Një plan pune që përshkruan afatin kohor të propozuar, detyrat dhe arritjet për projektin.

**Propozimi buxhetor:** Një propozim buxheti i detajuar që mbulon të gjitha shpenzimet që lidhen me projektin.

## 10. KRITETERT E VLERËSIMIT:

Propozimet do të vlerësohen në bazë të kritereve të mëposhtme:

- Ekspertiza dhe kualifikimet e aplikuesit/ekipit.
- Metodologjia dhe plani i punës.
- Buxheti dhe efektiviteti i kostos.

## 11. KONTAKTI:

Për pyetje dhe paraqitjen e propozimeve, ju lutemi kontaktoni:

**Diellza Bezera**

**judoksmanagement@gmail.com**

**+383 45 661 798**